



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

**RAPORT I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2025
PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK
TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

1. Përmbledhje ekzekutive

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në vijim MIE) ka miratuar 2 (dy) projekt-akte objekt të konsultimit publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, si dhe vendimit nr. 818, datë 26.12.2024 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025”, të Këshillit të Ministrave, konkretisht;

- Projekt-ligji “Për performancën energjetike të ndërtesave”, miratuar me ligjin nr. 37/2025;
- Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave”, i papapashikuar në PPAP 2025, miratuar me vendimin nr. 125, datë 28.02.2025.

Krahasuar me vitin e kaluar ministria ka performuar mirë lidhur me këtë proces, duke diversifikuar metodat e përdorura për konsultim publik dhe duke i përzgjedhur ato në varësi të kompleksitetit të akteve.

Një problematikë që vlen të theksohet është se ka shumë vizitorë, si nga qytetarë dhe ekspertë por janë të pakët ata që lënë komente në portalin e Regjistrimit Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike. Megjithatë, qytetarët/ekspertët kanë pasur mundësi dhe rrugë të tjera, si përsëmbull adresën e-mail për të përcjellë shqetësimet dhe paqartësitë e tyre.

2. Analiza e konsultimeve të kryera gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2025

2.1 Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Numri i përgjithshëm i akteve për të cilin Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kryer konsultim publik gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 është 2 (dy), konkretisht për:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

1. Projektligji “Për performancën energjetike të ndërtesave”;
2. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave”.

1.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

MIE ka miratuar 66 akte në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, nga të cilat 2 janë projektligje dhe 50 projektvendime.

1.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

2 (dy) projektakte i janë nënshtruar konsultimit publik. Në lidhje me pjesën tjetër të akteve të cilat janë miratuar, konkretisht 62 prej tyre, nuk kanë qenë objekt i konsultimit publik në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

1.1.3 Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

-Ndër projektaktet e parashikuara për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, u konsultua 1 (një) ligj me raport VNR-je. Një (1) prej akteve të miratuara gjatë kësaj periudhe nuk është objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të VKM nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

1.1.4 Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?


- Për 37 aktet e parashikuara në Programin Analitik gjatë vitit 2025, për 28 prej tyre janë përdorur kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, pasi nuk janë në listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik.
- Nga 22 aktet e parashikuara në PKIE, për 14 prej tyre aplikohen kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

- Nga 27 aktet e parashikuara në dokumentat strategjike kombëtare dhe sektoriale, për 17 prej tyre aplikohen kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Grafik 1: Përdorimi i kriterëve të përjashtimit nga konsultimi publik



1.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

1 (një) projektligj dhe 1 (një) projektvendim.

1.1.6 A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me performancën institucionale të vitit të kaluar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për periudhën e raportimit ka realizuar një proces efektiv konsultimi publik për projektaktet e miratuar.

2.2 Metodatat e konsultimit

2.2.1 Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik për projektligjin “Për performancën energjetike të ndërtesave”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

1. Publikimi i projektaktit dhe paketës shoqëruese, 1 Nëntor 2024, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJKP);
2. Nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë,
3. Adresa e emailit të personave të kontaktit nga drejtoria teknike si dhe Koordinatori Konsultimit Publik,
4. Diskutime konsultative me Institucionet shtetërore dhe përfaqësues të qeverisjes vendore.

Metodat e përdorura për konsultimin publik për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave” ishin:

1. Publikimi i projektaktit dhe paketës shoqëruese, 18 Dhjetor 2024, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJKP);
2. Nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë,
3. Adresa e emailit të personave të kontaktit nga drejtoria teknike si dhe Koordinatori Konsultimit Publik,
4. Diskutime konsultative me Institucionet shtetërore dhe përfaqësues të qeverisjes vendore.

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e postës elektronike të Koordinatorit për Njoftim dhe Konsultim Publik, 3 komente për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave dhe 35 komente për ligjin “Për performancën energjetike të ndërtesave”.

Përmes konsultimit publik nëpërmjet regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike dhe përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka pasur komente.

1.2.3 A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Për hartimin e projektaktit “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave”, është bashkëpunuar është hartuar nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Projektligji “Për performancën energjetike të ndërtesave” është përgatitur nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, si dhe është bashkërenduar me ministritë e linjës.

1.3 Kohëzgjatja e konsultimeve

1.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për aktet e planifikuara gjatë të vitit 2025 u realizua në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij, konkretisht:

Për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave”, morën pjesë morën pjesë kryesisht përfaqësues të institucioneve shtetërore si dhe Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë. Konsultimi zgjati nga data 18 Dhjetor 2024 deri në 15 Janar 2025.

Projektligji “Për performancën energjetike të ndërtesave” morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore si dhe Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, Unioni i Inxhinierëve Shqipëtar, Co-PLAN, Institute for Habitat Development dhe grupe të tjera. Konsultimi zgjati nga data 1.11.2024 deri në datë 29.11.2024.

1.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit përse i përket fazave paraprake dhe më pas publikimit në RENJK, është 9 (nëntë) muaj.

1.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Konsultimi për projektligjet e miratuara është zhvilluar bazuar mbi parimin e pjesëmarrjes dhe propocionalitetit, duke përzgjedhur metodat dhe targetuar aktorët që ndikohen nga politika e krijuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

1.4 *Palët e interesuara të përfshira*

1.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Për projektligjin “Për performancën energjetike të ndërtesave”, morën pjesë 4 përfaqësues kryesisht ekspertë të fushës së energjisë, ndërtimit dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore.

Për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave”, morën pjesë 4 përfaqësues ekspertë të fushës së ndërtimit si dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore.

1.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Për konsultimin e projektakteve gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2025, pjesëmarrësit ishin:

- Ekspertë,
- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë,
- përfaqësues nga aktorët e interesuar,
- përfaqësues nga Institucionet shtetërore dhe këshillat konsultativ.

1.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Gjatë procesit të konsultimit, aktorët e interesit të cilët dhanë komente dhe sugjerime me qëllim përmirësimin e projektaktit, nga:

1. Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave”,
2. Unioni i Inxhinierëve Shqipëtar, Co-PLAN, Institute for Habitat Development për projektligjin “Për performancën energjetike të ndërtesave”.

1.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Struktura e përfaqësuesve kontribues në konsultimet publike ishin:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

1. Shoqëria Civile; Shoqata; Unione etj.
2. Organet rregullatore,
3. Insitucionet e varësisë,
4. Këshillat konsultativ.

1.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata për gjashtëmujorin e parë 2025 paraqitet e njëjtë me vitin e kaluar. Procesi i konsultimi ka qenë proaktiv dhe gjithëpërfshirës, duke zhvilluar konsultime të fazuara dhe mundësuar kështu pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesit.

1.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

1.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Në regjistrin e konsultimeve publike nuk ka pasur komente/sugjerime nga aktorët e interesuar, por nëpërmjet postës elektronike ka pasur 3 komente nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Afatgjatë të Rinovimit të Stokut të Ndërtesave”, dhe 35 nga përfaqësues të Unionit të Inxhinierëve Shqipëtar, Co-PLAN, Institute for Habitat Development për projektligjin “Për performancën energjetike të ndërtesave”.

1.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?


Për projektaktet e konsultuara gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2025 numri total i komenteve të përcjella ka qenë 38 prej të cilave:

- 15 të pranuar plotësisht;
- 0 të pranuar pjesërisht;
- 23 të refuzuara.

Grafik 2:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË



1.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Konstatohet se tendenca ka mbetur e njëjtë me vitin e kaluar.

1.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Ka pasur një raport VNR për aktin e konsultuar, i cili është përditësuar në bazë të informacionit të marrë gjatë konsultimit publik.

1.6 Raportet mbi rezultatet e konsultimit

1.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka publikuar 2 (dy) raporte individuale konsultimi.

1.1.1 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Janë publikuar 2 (dy) raporte individuale konsultimi për aktet e konsultuara.

1.2 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

Duke marrë në konsideratë metodologjinë e pikëzimit “Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit të qeverisë, është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit; janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, në draftin e ri pasqyrohet dhe reflektohet reagimi të palëve të interesuara”, konsultimi publik për projektligjet, vlerësohet me 8 pikë.

2. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Për sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik mund të përmendim gjithpërfshirjen e publikut, ndërmjet një angazhimi më të madh në këtë proces. Me qëllim përmirësimit e procesit të konsultimit publik, sugjerohet organizimi i konsultimeve përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik.